



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun



Rruga "Durrësit", nr. 83, Tiranë. Tel/Fax: 04 227850. E-mail: iss@iss.gov.al. web: www.iss.gov.al

Nr. 10438 Prot.

Tiranë, më 29.12.2015

FTESË PËR NEGOCIATA

Instituti I Sigurimeve Shoqërore, në mbështetje të VKM Nr. 1195, dt. 05.08.2008, kërkon të realizojë procedurën për "Prodhim spote dhe dokumentare sensibilizues" me objekt: Sensibilizimin e qytetarëve për tërheqjen e pensione në bankat e nivelit të dytë.

Nevoja për kryerjen e programit: Prodhim spote me qëllim: Sensibilizimin e qytetarëve për tërheqjen e pensione në bankat e nivelit të dytë.

Shpeshtësia e shfaqjes së reklamës/ spotit: Transmetimi nuk përfshihet në këtë kontratë.

Numri i Spoteve: 1 spot me kohëzgjatje minimale 30 sekonda.

Periudha e realizimit të spotit: 5 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit i përcaktuar: 1.680.000 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetëmijë) me TVSH.

Afati i fundit për paraqitjen e konfirmimeve nga organet e masmedias/ agjencitë e specializuara është deri më dt. 7 janar 2016 pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave: Ofertat duhet të vijnë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura në zarf, të shënuara me adresë dhe emërtimin e subjektit, në rast të kundërt ata do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit tonë kontraktor:

Emri	INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
Adresa	Rr. Durrësit, nr. 83, Tirane
Tel/Fax	04 /2 278 50
Adresa e Internetit	www.iss.gov.al
në emër të	Komisionit per Ndjekjen e Procedurave per Realizimin dhe Transmetimin e Spotit Publicitar.
E-mail	mzenelaj@iss.gov.al

Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave janë:

Shqip **X** Anglisht
Tjetër _____

OBJEKTI I SPOTIT:

Prodhim spoti me qellim: Sensibilizimi i publikut për tërheqjen e pensioneve në bankat e nivelit të dytë.

Termt e References:

Qëllimi i këtij spoti është sensibilizimi i qytetarëve për tërheqjen e pensioneve në bankat e nivelit të dytë. Duke iu referuar kërkesave nga vetë qytetarëve si dhe nevojës për përmirësimin akoma edhe më të mirë të shërbimeve që ofron ISSH—ja shihet si nevojë zgjerimi i numrit të operatorëve që ofrojnë shpërndarjen e pensioneve. Ky spot duke pasur parasysh numrin e madh të bankave që do e ofrojnë këtë shërbim do të fokusohet në thirrjen që do t'u bëhet qytetarëve për ta marrë këtë shërbim në bankë, por pa specifikuar se në cilën prej tyre sepse kjo është zgjidhje personale e çdo përfituesi.

Në këtë prodhim duhet të përfshihet pjesëmarrja e një personazhi, i cili duhet të jetë një nga figurat e njohura të fushës së artit në Shqipëri. Gjithashtu në këtë spot duhet të përfshihen foto të ndryshme, regjistrime dhe filmimeme, të cilat të përçojnë mesazhin e qartë dhe të plotë tek qytetarët për mundësinë e përzgjedhjes që ata kanë.

INFORMACIONE APO KËRKESA SHITESË:

Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur si kriter kualifikues:

Ekstrakt dhe gjendje e regjistrit të QKR, që vërteton se operatori ushtron aktivitetin ekonomik tregtar me objektin e procedurës së negociimit. Gjendja e Regjistrit duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna:

1. Se operatori nuk është në proces falimentimi,
2. Se operatori nuk është dënuar për shkelje penale,
3. Se operatori nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.

Vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore ku vërtetohet se:

- a) Ka plotësuar detyrimet fiskale,
- b) Ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore
- c) Bilancet e dy viteve të fundit financiare
- ç) Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar i lëshuar brenda 3 muajve të fundit (vërtetimet e QKR dhe administratës tatimore)
- d) Ofertën ku të jetë specifikuar oferta për prodhim spoti dhe prodhim dokumentari.
- dh) Strategjia për idenë e realizimit.
- e) CV të firmës dhe përshkrim të detajuar të projekteve / kontratave të ngjashme. Kontrata të së njëjtës natyrë të realizuara gjatë dy viteve të fundit, do të vlerësohen me sistem pikëzimi.
- f) Të ketë mbi 12 punonjës të siguruar.

Përzgjedhja e ofertave sipas pikës nr. 7 të VKM nr. 1195 datë 5.8.2008

Vlerësohet me 25 pikë Ideja e realizimit të Reklamës / spotit e cila përmban:

• Regjia, montazhi efektet + 3D Compositing, audio- video, filmimet me Kamer (Arri Alexia) me të gjithë aksesoret, Color grading (rregullimet e koloreve) Davinci, staf profesional, drejtor fotografie të huaj etj), përshtatshmeria e projekteve të paraqitura studiot = 20 pikë

• Vlerësohet me 25 pikë kontrata të ngjashme:

Numri më i madh i projekteve (buxheti i kontratave të ngjashme) vlerësohet me maksimumin e pikëve dhe në rend zbritës në mënyrë përpjestimore.

Vlerësohet me 50 pikë oferta më e ulët ekonomike e operatorit, bazuar në:

(Përllogaritja e pikëve do të bëhet sipas kësaj metodologjie:

$$Pe = 100 \times \frac{Cu}{C}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Organin e masmedias: $X = (\text{pikët e propozimit tekniko artistik} \times 0.25)$

Pesha për Propozimin Artistik: $Y = (\text{pikët e propozimit tekniko artistik} \times 0.25)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Z = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = X + Y+Z

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në Lek me TVSH do të jete zë i veçante në ofertë si dhe në kontratë.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave përfaqësuesit apo personat me autorizim.


Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore ose dorazi para komisionit në datën dhe orën e përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim!

Drejtores e Përgjithshme

Vjollca BRAHO

The image shows a circular official stamp of the Social Insurance Institute of Albania (Instituti i Sigurimeve Shoqërore të Shqipërisë). The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE', 'INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE', 'TIRANE', and 'DREJTORES E PËRGJITHSHME'. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink.